

**VENDIM**  
**Nr.837, datë 29.7.2009**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 248, DATË 27.4.2007 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË  
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në pikën 3 të vendimit nr.248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Përcakton standardet TIK, që do të përdorin Kryeministria, ministrinë dhe institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit/ministrit. Këto standarde publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Në rastet kur standardet mungojnë dhe/ose janë të pazbatueshme, institucionet e mësipërme janë të detyruara, në çdo rast, të marrin, përpara fillimit të procedurave të prokurimit publik, mendimin e AKSHI-t.”.

b) Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l”, me këtë përmbajtje:

“l) Gjatë planifikimit të projektbuxhetit të shtetit, Ministria e Financave duhet të marrë mendimin e AKSHI-t, i cili është organ teknik-këshillimor i institucioneve, të përmendura në shkronjën “ç”, për kërkesat e tyre, për financimin me fonde buxhetore të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik, që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**